



Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University			
Planuar për datën 21.05.2024			
Numri i Serisë	Numri i Aktit	Numri i Aktit	Numri i Aktit
01	2103		



MARRËVESHJE

BASHKËPUNIMI

Në mes:

UNIVERSITETIT PUBLIK "KADRI ZEKA", GJILAN

DHE

KOMUNËS SË KAMENICËS

Universiteti "Kadri Zeka", Gjilan, i përfaqësuar nga Rektori Prof. Asoc. Dr. Artan DËRMAKU dhe Komuna e Kamenicës, e përfaqësuar nga Kryetari z. Kadri RAHIMAJ, pajtohen të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimit të shumanshëm në funksion të zhvillimit institucional.

Me vullnet të mirë palët u pajtuan si në vijim:

Neni 1 **Qëllimi i Marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit është përcaktimi i fushave dhe mënyrave të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve të sipërsënuara.

Të dyja këto institucione do të kenë qëllim të përbashkët përkrahjen e studentëve gjatë studimeve dhe identifikimin e iniciativave për promovimin dhe mbështetjen profesionale në zhvillimin e gjithëmbarshtëm socio-ekonomik të rajonit ekonomik të dy institucioneve.

Rekomandimet dhe ekspertiza profesionale janë të nevojshme veçmas në: idetë, projektet lokale dhe ndërkombëtare, pilot-projektet dhe programet e caktuara që kanë segmente të rëndësishme të angazhimit me këtë marrëveshje.



Neni 2 **Forma e Bashkëpunimit**

Bashkëpunimi ndërmjet dy Institucioneve do të përfshijë:

- a. Mundësimin e mbajtjes së punës praktike për studentët e UKZ-së, nëpër drejtoritë komunale të Komunës së Kamenicës;
- b. Përkrahjen e studentëve me bursa studentore komunale;
- c. Institucionalizimin e bashkëpunimit reciprok dhe të ndërsjellë në sferën e ofrimit të ndihmës për ngritjen e kapaciteteve të studentëve të këtyre universiteteve;
- d. Ndërlidhja institucionale e dy bibliotekave;
- e. Mbështetja me ekspertiza të ndryshme nga të dy institucionet në projekte dhe aktivitete të ndryshme;
- f. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore dhe formuese;
- g. Shkëmbimin e përvojës lidhur me menaxhimin institucional;
- h. Bashkëpunimin në organizimin e aktiviteteve dhe/ose projekteve lokale dhe ndërkombëtare me interes të përbashkët;
- i. Shkëmbimin e eksperiencave, praktikave dhe ekspertëve;
- j. Zhvillimin e programeve hulumtuese, projekteve kërkimore-shkencore, dhe projekteve të tjera të cilat janë me interes të të dy institucioneve;
- k. Organizimin e përbashkët të konferencave, trajnimeve, seminareve, ngjarjeve kulturore dhe bashkëpunimeve të tjera profesionale;

Neni 3 **Financat**

Të dy Institucionet bien dakord që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshme nga secili institucion. Për detajimin e bashkëpunimit në fushat e mësipërme (1/a-i) dhe ndjekjen e zbatimit të Marrëveshjes, realizohet nga i ngarkuari i Rektorit/ Kryetarit, nga secili Institucion. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nuk ka implikime financiare nga cilado palë, megjithatë marrëveshjet specifike dhe eventuale financiare për aktivitete të veçanta do të përcaktohen paraprakisht, nëse ka raste të tilla.



Neni 4 **Ndryshimi dhe plotësimi i bashkëpunimit**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është dokument bazë dhe për ndryshimet dhe plotësimet e saj si dhe për marrëveshjet tjera të veçanta të arritura ndërmjet palëve do të bëhen diskutime paraprake. Ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme si dhe marrëveshjet e veçanta bëhen në mënyrën si në vijim:

- Mosmarrëveshjet eventuale palët do të përpiqen që t'i tejkalojnë me mirëkuptim;
- Ndryshimet ose plotësimet e Marrëveshjes do të jenë efektive pas pajtueshmërisë së palëve dhe nënshkrimit të tyre;
- Marrëveshjet e mëtutjeshme lidhur me ndonjë organizim të veçantë, me të drejta dhe detyrime reciproke ndërmjet palëve, nuk do të jenë efektive përderisa nuk përpilohen dhe nënshkruhen nga përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve;

Marrëveshja mund të priset nëse palët e argumentojnë se e njëjta nuk mund të funksionojë sipas frymës së saj;

Neni 5 **Kohëzgjatja dhe efektet juridike**

Kjo Marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit. Ajo rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur, kur të dy Institucionet janë dakord për këtë. Nëse njëri prej Institucioneve kërkon të zgjidhë këtë marrëveshje duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 60 (gjashtëdhjetë) ditë përpara.

Mos rinovimi i kësaj Marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga Palët e interesuara të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.

Neni 6 **Standardet**

Të dyja palët janë të obliguara të përmbushin këtë Marrëveshje me ndershmëri (integritet) të lartë dhe standarde profesionale, etike dhe kompetencë.



**Neni 7
Gjuha e kontratës**

Kjo Marrëveshje do të përpilohet në gjuhën Shqipe.



**Neni 8
Mospajtimet**

Të gjitha mospajtimet ndërmjet palëve zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet tyre.

**Neni 9
Hyrja në fuqi**

Palët do të fillojnë zbatimin e këtij bashkëpunimi menjëherë pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.

Kjo Marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqipe dhe pasi lexohet, firmoset nga të lartpërmendurit.

PËR: UNIVERSITETIN "KADRI ZEKA", GJILAN		PËR: KOMUNËN E KAMENICËS	
Emri:	Z. Artan Dërmaku	Emri:	Z. Kadri Rahimaj
Pozita:	Rektor	Pozita:	Kryetar
Nënshkrimi/Vula:		Nënshkrimi/Vula:	
Data/ Vendi:	21 . 05 . 2024, Gjiilan	Data/ Vendi:	21 . 05 . 2024, Gjiilan

